REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr. 2372/2 Prot.

Tiranë, më 30.10.2026

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ASCAP

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1179 Prot.

Tiranë, më 30.10.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR
KOORDINIMIN E PUNËS SË NDËRSJELLË DHE INSTITUCIONALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE

E lidhur sot, më datë 30.10.2026, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. **Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,** (referuar më tej si **"Autoriteti"/"AIDSSH"**), me seli në Tiranë, me adresë në Njësinë Administrative nr. 4, rruga "Kongresi i Manastirit", garnizoni "Skënderbej", përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, kryetar i Autoritetit,

dhe

2. **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, ,** (referuar më tej si **"ASCAP"**) me seli në Tiranë, me adresë, rruga "Naim Frashëri", nr. 37, përfaqësuar nga z. Gerti Janaqi, drejtor i ASCAP-it.

Palët janë marrë vesh se, për të konkretizuar bashkëpunimin ndërmjet tyre, do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje siç janë të shprehura më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet AIDSSH-së dhe ASCAP-it për mbështetjen e përdorimit të burimeve arkivore me vlerë historike në funksion të arsimit parauniversitar, nëpërmjet platformës digjitale "Mësojmë nga e Kaluara: Burime të Hapura 1944–1991".

Bashkëpunimi synon përmirësimin e cilësisë së përdorimit pedagogjik të këtyre burimeve, në përputhje me kurrikulën dhe standardet në fuqi.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje lidhet duke u bazuar në: Ligjin nr. 45/2015, "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë*", e ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 93, datë 27.02.2019, *"Për Përcaktimin e Tarifave dhe të Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"*; Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 98, datë 27.02.2019, *"Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)"*; Rregullores *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"*, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; si dhe në Planin Strategjik 2023-2028 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Neni 3

Objekti i bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ka si objekt:

a) Ofrimin nga ASCAP-i të ekspertizës pedagogjike dhe metodologjike për vlerësimin e përshtatshmërisë së materialeve për përdorim në arsimin parauniversitar;

b) Dhënien e rekomandimeve profesionale për përmirësimin e përdorimit didaktik të burimeve arkivore në procesin mësimor;

c) Mbështetjen e integrimit të materialeve në përputhje me kurrikulën dhe standardet e cilësisë në fuqi;
d) Bashkëpunimin në zhvillimin e materialeve mbështetëse për mësuesit;
e) Informimin e institucioneve arsimore mbi mundësinë e përdorimit të platformës, pa krijuar detyrim për përdorimin e saj;
f) Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ASCAP-it në struktura këshillimore, me rol konsultativ dhe jo vendimmarrës;
g) Bashkëpunimin në organizimin e aktiviteteve informuese dhe trajnimeve, në përputhje me kompetencat dhe burimet e secilës palë.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. ASCAP-i ofron ekspertizë pedagogjike dhe metodologjike, ndërsa përgjegjësia për përmbajtjen shkencore dhe historike të materialeve i takon AIDSSH-së dhe ekspertëve të fushës, që përzgjidhen nga vetë AIDSSH-ja.
2. Kjo marrëveshje nuk i jep ASCAP-it rol akreditues, certifikues apo miratues për platforma, përmbajtje apo produkte digjitale.
3. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje realizohet:
   a) Në përputhje me kompetencat ligjore të secilës palë;
   b) Brenda burimeve njerëzore dhe financiare ekzistuese;
   c) Pa krijuar detyrime shtesë financiare për të dyja palët;
4. Përdorimi i platformës në institucionet arsimore është opsional dhe jo i detyrueshëm.
5. Materialet duhet të përdoren duke ruajtur burimin dhe integritetin e tyre.
6. Në çdo rast, AIDSSH-ja do të konfirmojë çdo material dhe përmbajtjen përkatëse që do të hidhet dhe publikohet në Platformë.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, AIDSSH-ja dhe ASCAP-i kanë të drejta dhe detyrime, si dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të qëllimeve për të cilat ushtrojnë veprimtarinë.
2. Konkretisht, Autoriteti angazhohet:
   a) Të vërë në dispozicion dokumente arkivore të deklasifikuara dhe materiale të përpunuara në format të përshtatshëm për përdorim arsimor;

b) Në bashkëpunim me institucione të kërkimit shkencor, të garantojë saktësinë historike dhe integritetin dokumentar të materialeve të ofruara;

c) Të kontribuojë me ekspertizë shkencore, sipas mundësive që disponon, në hartimin dhe përshtatjen e burimeve arsimore;

d) Të bashkëpunojë në organizimin e aktiviteteve informuese, trajnimeve apo tryezave të përbashkëta për mësuesit dhe specialistët e arsimit;

e) Të sigurojë respektimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përdorimin e dokumenteve arkivore.

3. Konkretisht, ASCAP-i angazhohet:

a) Të vlerësojë përshtatshmërinë pedagogjike dhe metodologjike të materialeve;

b) Të japë rekomandime profesionale për përdorimin e tyre;

c) Të kontribuojë në aktivitete zhvillimi profesional, sipas mundësive;

d) Të mbështesë informimin e institucioneve arsimore mbi mundësinë e përdorimit të materialeve dhe të platformave.

4. ASCAP-i nuk mban përgjegjësi për:

a) Përmbajtjen shkencore dhe interpretimin historik të materialeve;

b) Përdorimin e materialeve nga palë të treta ose nga mësuesit;

c) Çdo ndryshim të materialeve nga palë të treta.

5. Palët miratojnë jo më vonë se tre-mujori i parë i çdo viti kalendarik, planin e punës, i cili do të përmbajë veprimtaritë, afatet dhe detyrat e përgjegjësitë e palëve. Përjashtim nga ky afat bën viti i datës së nënshkrimit të marrëveshjes. Gjithmonë, plani i përbashkët do të kryhet pasi të jenë shkëmbyer planet përkatëse vetjake të secilës palë ndërmjet njëra-tjetrës.

6. Palët angazhohen për promovim të përbashkët dhe të njëllojtë të veprimtarive të përbashkëta që kanë të bëjnë me Platformën, si gjatë ngritjes ashtu edhe pas publikimit dhe nisjes së veprimtarisë së Saj, në mediumet e tyre zyrtare (faqe interneti, rrjete sociale, publikime, etj.).

7. Në çdo rast, AIDSSH-ja do të konfirmojë çdo material dhe përmbajtjen përkatëse që do të hidhet dhe publikohet në Platformë.

Neni 6

Të drejtat e shfrytëzimit dhe pronësia intelektuale

1. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste të periudhës kohore 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 (në vijim "Materialet

Dokumentare"), të cilat zotërohen nga Autoriteti, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, janë në pronësi të vetme të Autoritetit.

2. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve përkatëse, të cilat zotërohen nga ASCAP-i në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, janë në pronësi të vetme të ASCAP-it.
3. Materialet e krijuara në bashkëpunim përdoren me marrëveshje të ndërsjellë. ASCAP nuk mban përgjegjësi për përdorimin publik të materialeve në platformë.
4. Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe të planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për periudhën e kohës gjatë së cilës zgjat marrëveshja. Gjithmonë, palët do të ruajnë përkatësinë pronësore dhe shpërndarëse të materialeve, duke përmendur kontributin e vënies në dispozicion.
5. Të gjitha pronat intelektuale, të cilat krijohen si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi dhe në kuadrin e veprimtarive që rrjedhin prej tij, me kontributin e të dyja palëve, do të jenë në pronësi të të dy institucioneve dhe do të shfaqen e do të komunikohen te palë të treta ose te publiku, në çfarëdo forme komunikimi dhe transmetimi, përherë duke përmendur kontributin e të dyja palëve. Ky parashikim do të vlejë përherë dhe i shtrin efektet e tij detyruese mbi palët edhe në rast se kjo marrëveshje zgjidhet.
6. Në kuadër të përcaktimeve të pikës 4 të këtij neni, dhe të vetë kësaj marrëveshjeje në tërësi, palët merren vesh, se përsa i takon Platformës, pronësia intelektuale dhe të drejtat e lidhura e shoqëruese me të, i takojnë vetëm Autoritetit, dhe se ASCAP-i nuk ka dhe nuk do të parashtrojë asnjë pretendim në lidhje me këtë të drejtë, përveçse për njohjen e kontributit të dhënë për Platformën dhe për të drejtën pronësore për materialet që do të japë në kuadër të punës, qofshin në bashkëpunim me Autoritetin apo të përpiluara vetë, siç parashikon pika 4 e këtij neni.

Neni 7

Kufizimet/Garancia

1. Palët merren vesh, se ky bashkëpunim nuk nënkupton dhe nuk sjell asnjë ndërhyrje në kompetencat, veprimtarinë apo funksionet e secilës prej tyre.
2. Të dyja palët merren vesh, se ato nuk mund të përdorin imazhe ose përshkrime të dëshmive, intervistave, filmave, punimeve, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen palës tjetër, ose këtij bashkëpunimi, në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e palës tjetër ose të aktiviteteve të tyre.

3. Palët merren vesh që vulat e secilës prej tyre, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë, etj., të cilat mund të jenë të pranishëm në faqen e internetit të secilës, nuk do të keqpërdoren nga asnjëra prej tyre, në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e secilës prej palëve janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar nga pala tjetër, si dhe nuk do të përdoren si fakt për të qenë superiorë ndaj ndonjë produkti apo shërbimi tjetër.
4. Në kuptim të këtij neni, palët merren vesh dhe pranojnë të garantojnë njëra-tjetrën, se në kuadër të përdorimit të njëanshëm të materialeve që mund të vënë në dispozicion në shërbim të njëra-tjetrës, ato nuk do të mbajnë përgjegjësi për keqinterpretimin dhe keqpërdorimin që mund të bëhet nga pala tjetër që është marrëse dhe përdoruese e këtij materiali ose nga një palë e tretë.

Neni 8

Shpërndarja e materialeve

1. Materialet e mbledhura dhe të krijuara rishtas si rezultat i bashkëpunimit, mund të publikohen dhe të transmetohen anembanë në platforma të shumëfishta të transmetimit, nën siglën e të dyja palëve. Kjo mund të bëhet edhe në rast se marrëveshja zgjidhet, e në këtë rast palët detyrohen të zbatojnë parashikimet e pronësisë intelektuale sipas kësaj marrëveshjeje dhe ligjit në fuqi për pronësinë intelektuale.
2. Gjithmonë, palët do të kenë parasysh që materialet të shpërndahen dhe të publikohen vetëm:
   a) Me pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve;
   b) Në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe për mbarëvajtjen e saj, palët merren vesh për caktimin e personave të kontaktit, të cilët do të luajnë rol koordinues për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
2. Secili institucion do të caktojë një koordinator përgjegjës për të lehtësuar komunikimin dhe zbatimin e veprimtarive të përbashkëta, të cilët do të jenë përgjegjës për organizimin e takimeve, shkëmbimin e informacionit dhe ndjekjen e detyrave të

përcaktuara në këtë marrëveshje. Ky koordinator më tej do t'i komunikohet dhe palës tjetër.

3. Koordinatorët do të mbajnë takime ndërmjet tyre (fizikisht dhe/apo virtualisht) në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit, si dhe do të informojnë titullarin përkatës të institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për të vlerësuar programin e bashkëpunimit dhe të planeve të shkëmbyera e të përbashkëta në përputhje me parashikimet që përmban kjo marrëveshje, me synim caktimin e hapave të mëtejshëm.
4. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit elektronik.
5. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohen personat e parashikuar në pikat e mësipërme.

Neni 10

Përmirësimet, ndryshimet, shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë, si dhe bazuar në kompetencat e secilit institucion.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë, do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e të dyja palëve, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjë në fuqi vetëm pas nënshkrimit nga të dyja palët.

Neni 11

Mirëbesimi

1. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis palëve.

Neni 12

Forca madhore

1. Moskryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një pale e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të konsiderohet shkelje e përcaktimeve të kësaj

2. Marrëveshja nënshkruhet në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe dy të tjera do të depozitohen në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, palët pranojnë me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar që të ndërmarrin përsipër detyrimet siç shprehen në tekstin e saj, dhe se nënshkrimi i marrëveshjes zëvendëson çdo formë tjetër dakordësie apo negocimi që palët mund të kenë patur apo zhvilluar përpara datës së nënshkrimit.

PËR

AUTORITETIN PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

KRYETARI

Gentiana Sula

PËR

AGJENCINË E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORI

Gerti Janaqi